



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT

Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ligji nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjet, nr. 04/L-042, nr.04/L-111, dhe numër 05/L-009. Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 14.03.2024, pas shqyrtimit të Raportit Vjetore për vitin 2023, njëzëri mori vendim për aprovimin e RV/23.

Vendim: Nr.3 / 2024

RAPORTI VJETOR I K.R.U "HIDRODRINI" SH.A., PEJË PËR VITIN 2023

	Delegoi:	Aprovoi:
Emri dhe Mbiemri	Dri Cena Kryeshef Ekzekutiv	Jusuf Nikçi Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi:		
Datë:	14.03.2024	14.03.2024



HIDRODRINI

K.R.U. "HIDRODRINI" SH.A. - PEJË



**RAPORTI VJETOR
I PERFORMANCËS
PËR VITIN 2023**

Përmbajtja

1.	Hyrje.....
2.	Raporti i kryesuesit të Bordit të drejtorëve
3.	Departamenti për administratë.....
3.1	<i>Punët e kryera nga Sekretarja për Bordin e Drejtorëve Janar – Dhjetor/2023</i>
3.2	<i>Burimet njerëzore</i>
3.3	<i>Mbrojtje dhe siguri në punë</i>
3.4	<i>Shërbimi juridik</i>
4.	Departamenti teknik
4.1	<i>Sektori për planifikim dhe zhvillim</i>
4.2	<i>Sektori i ujësjellësit</i>
4.3	<i>Sektori i kanalizimit</i>
4.4	<i>Sektori i pompave</i>
4.5	<i>Treguesit kryesorë të performancës</i>
5.	Kualiteti i ujit
6.	Departamenti financiar
6.1	<i>Performanca e KUR "Hidrodrinit" Sh. A. - Pejë, Viti 2023</i>
6.2	<i>Pasqyrat Financiare 2023</i>
	<i>NUI: 811336975</i>
6.3	<i>Informata mbi kompaninë</i>
6.4	<i>Deklarata e përputhshmërisë</i>
6.5	<i>Zotimet dhe kontingjentet</i>
7.	Prokurimi.....
7.1	<i>Puna – Projektet kapitale</i>
7.2	<i>Furnizimet</i>
7.3	<i>Shërbimet</i>
8.	Departamenti komercial.....
8.1	<i>RAPORTI I PËRGJITHSHËM</i>
9.	Auditori i brendshëm.....
9.1	<i>Hyrje</i>
9.2	<i>Auditimi i brendshëm</i>
9.3	<i>Rezultatet e veprimtarisë së AB</i>
9.4	<i>Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm</i>
9.5	<i>Rekomandimet, pranimi dhe zbatimi i tyre</i>
9.6	<i>Rekomandimet</i>
10.	Teknologjia informative.....
10.1	<i>Zhvillimet / të arriturat</i>
10.2	<i>Aktivitete në proces e sipër</i>
10.3	<i>Mospërmbushje e planifikimeve</i>
10.4	<i>Çështjet që do të trajtohen në të ardhmen</i>

1. Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës, është pronare e shoqërive aksionare me kapital publik. Kompania Rajonale e Ujësjesit "Hidrodrini" SH. A., themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74, të datës 14.07.2009 dhe të Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1, të datës 30.09.2009. Shoqëria është trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike, Kompania e Ujësjesit Rajonal "Hidrodrini" Holding SH. A

Numri popullatës që Kompania Rajonale, "HIDRODRINI" iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 187.000 banor, gjegjësisht me 1.202 Km gjatësi të rrjetit të ujësjesit ndërsa shërbimet e ujërave të zeza ~ 60,000 banor, gjegjësisht me 584 Km gjatësi të rrjetit të ujërave të zeza. Kapaciteti momental prodhues sillet 38.641.478 m³/vjet.

Kompania është dhe do të mbetet ofrues profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lart dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Qendra e kompanisë është në Pejë, në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.

Bordi i Drejtoreve i përzgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur dhe bënë drejtimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Stafi menaxhues i kompanisë organizon punën, kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë dhe stafit.

Raporti Vjetor i KRU " Hidrodrini" Sh. A. - Pejë për vitin 2023 është përpiluar duke u bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dispozitën 28.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike të lëshuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike .

2. Raporti i kryesuesit të Bordit të drejtorëve

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes përgjatë vitit 2023.

Bordi i Drejtorëve e ka mbajtur mbledhjen e parë konstituive me datë 16 janar, 2023. Në këtë mbledhje BD është njoftuar me ish menaxhmentin e KRU "Hidrodrini", SH.A në Pejë, si dhe metë arriturat e caqeve duke u mbështetur në Plan të Biznesit të hartuar nga ai menaxhment dhe aprovuar nga BD paraprak.

Gjatë mbledhjeve të rregullta me ish menaxhmentin, Bordi i Drejtorëve ka konstatuar se aktivitetet dhe angazhimet në ndërmarrje nuk ishin në përputhshmëri me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare Nr.06/L-016 dhe me politikën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për KRU "Hidrodrini" SH.A.

Duke u mbështetur në të dhënat e raporteve financiare, BD në mbledhje të rregullt mori vendime shpall konkurset për ish menaxhmentin e lartë në bazë të një procesi transparent dhe konkurses në pajtim me politikën e rekrutimit të ndërmarrjes duke u mbështetur në ligjet në fuqi.

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidrodrini" SH.A bëri selektimin e kandidatëve të rinj dhe emëroi kryeshefin ekzekutiv, sekretarin dhe zyrtarin kryesor financiar.

Të gjitha këto aktivitete kanë të bëjnë me krijimin e kushteve që me kuadro të përgjegjshme kompania t'i realizoj synimet e planifikuara sipas Planit të Biznesit, si dhe të vihen në përputhje me politikën e Ministrisë së Linjes dhe Qeverisë.

Për t'i arritur këto synime, BD në mbledhjet e rregullta dha shumë rekomandime dhe sugjerime për menaxhmentin e ri, ku kerkoi në mënyrë të vazhdueshme që të zvogëlohen shpenzimet operative dhe jooperative të cilat po e rëndojnë rezultatin financiar të kompanisë përgjatë vitit 2023.

Gjithashtu, BD në mbledhjet e rregullta kërkoi nga menaxhmenti i ri që të shtohet kujdes në shpenzimin e parasë së gatshme e cila shpenzohet pa dhënë arsyeshmëri nga menaxhmenti. Për më tepër, BD në mbledhjet e rrregullta kërkoi nga menaxhmenti i ri që të rritet inkasimi, të zvogëlohen humbjet e ujit, të zvogëlohen llogaritë e arketueshme dhe lëndët të dërgohen me kohë tek përmbartësit.

Përgjatë vitit 2023 konstatohet se mbledhjet e Bordit të Drejtorëve ishin mirë të organizuara dhe të sinkronizuara me një integritet profesional dhe etik pune, me kuorum të plotë në marrjen e vendimeve strategjike në të mirë të kompanisë duke dhënë rekomandime të njëpasnjëshme dhe duke monitoruar menaxhmentin e lartë.

Pra, theksoj se përgjatë vitit 2023, Bordi i Drejtorëve në total ka dhënë 135 rekomandime dhe 50 sugjerime për Menaxhmentin e lartë.

Në çdo mbledhje, BD ka shqyrtuar raportet operative financiare mujore dhe duke u mbështetur në këto raporte të hartuara nga menaxhmenti ka dhënë rekomandimet e veta dhe pakënaqësitë që e kanë përcjell kompaninë, si: rritja e shpenzimeve, matja e saktë e prodhimit të ujit, inkasimi në krahasim me vitin paraprak, etj.

BD ka analizuar raportet financiare zë për zë për secilën njësi dhe i ka sugjeruar KE-së dhe ZKF-së që raportet financiare të përpilohen me profesionalizëm më të madh, pasi që nga këtoraportet financiare dhe në bazë të tyre BD merr vendime, si për paga ashtu edhe vendime të tjera që ndikojnë në pasqyrat financiare.

Nese krahasojmë humbjet e ujit të vitit 2023 me humbjet e ujit të vitit 2022, BD konstaton se figurat nuk janë të sakta, pasi që prezantimi i prodhimit të ujit dhe humbjeve të ujit në vitin 2022 ishte i pasaktë, andaj edhe krahasimet e viteve 2023 me 2022 në këtë rast nuk kanë kuptim. BD ka kërkuar nga menaxhmenti përpilimin e strategjisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit të prodhuar për shitje duke kërkuar edhe formimin e task forcës për identifikimin e keqpërdorimeve të ujit dhe rritjen inkasimit.

Nese menaxhmenti i merr me seriozitet rekomandimet e dhëna nga BD, rezultatet janë shumë të pritshme që KRU "Hidrodrini" SHA përgjatë vitit afarist 2024 dhe 2025 do të afrojo me rezultate pozitive financiare dhe do të arrihen caqet e Planit të Biznesit.

Vlen të theksohet se njëri nga rekomandimet e BD ishte edhe rekomandim i ARRU-së vendosja e ujëmatësve në të gjitha pikat e prodhimit, i cili rekomandim është realizuar.

Me këtë kemi arritur të kemi pasqyrë të saktë të prodhimit të ujit për herë të parë.

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidrodrini" SH.A., si përfaqësues i aksionarit në kompani është i përkushtuar në mbikqyrjen e veprimtarisë së kompanisë, në koordinim të vazhdueshëm me NJPMNP dhe në harmoni me politikën e Ministrisë së Linjës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Jusuf Nikçi, kryesues i bordit
KRU HIDRODRINI, SH.A. Pejë

3. Departamenti për administratë

Veprimtaria e zhvilluara nga Departamenti Administrativ gjatë vitit 2023

3.1 Punët e kryera nga Sekretarja për Bordin e Drejtorëve Janar – Dhjetor/2023

Caktimi mbledhjeve përpilimi agjendës së mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit. Njoftim i aksionarit për datën dhe kohën e takimeve. Përgatitja e materialeve për mbledhjet organizuara, kompletimi i të gjithë raporteve. Dorëzimi i raporteve përmes emailit dhe shtypja materialeve në kopje fizike për mbledhjet e Bordit dhe Komisionit Auditimit, është dorëzuar Plani Biznesit 2024-2025 dhe Raportet TM1, TM2, TM3, TM4(22) -Tremujore / 2023 sipas afateve ligjore. Është bërë plotësim ndryshimi i Statutit të Kompanisë me të dhënat e Kryeshefit të ri dhe janë kryer të gjitha veprimet për ndryshimet e kërkuara në ARBK. Është mbajtur Mbledhja Vjetore me Aksionarin 2023. Është vazhduar kontrata e punës së zyrtares së lartë Auditores së Brendshme. Është zgjedhur Sekretarja e Kompanisë, Kryeshefi Ekzekutiv, është bërë vlerësimi i performancës së Kompanisë për vitin / 2022 nga Bordi Drejtorëve, është marrë Vendim për rishpashpallja e konkursit për ZKF dhe i njëjti është zgjedhur.

Materialet e mbledhjeve janë përcjellë në mënyrë elektronike dhe në kopje fizike sipas afateve ligjore.

Janë përpiluar Draft procesverbalet e mbledhjeve dhe janë përcjellë tek drejtorët e bordit dhe aksionari në afatin ligjor. Procesverbalet finale janë plotësuar me përmirësime teknike nga ana e Drejtorëve të Bordit të protokolluara dhe nënshkruara dhe skanuara përcillen tek aksionari, bashkangjitur dhe vendimet e Bordit Drejtorëve.

MBLEDHJET DHE VENDIMET E Bordit të Drejtorëve/2023

Mbledhja konstituive e Bordit të Drejtorëve e datës 16/Janar/ 2023

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 03/ Shkurt/2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për TM2 - 2022.
2. Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për TM3 - 2022.
3. Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për Dhjetor dhe TM4 - 2022, me vërejtjet dhe komentet e dhëna.
4. Aprovohet Plani i Biznesit dhe Buxheti Vjetor i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për periudhën 2023-2025, me vërejtjet dhe komentet e dhëna për korrigjim dhe plotësim.
5. Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për TM1 - 2022.
6. I. Ndryshohet Statuti i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidrodrini" Sh.A. Pejë
II. Ky ndryshim bëhet në pajtim me nenin 197 paragrafi 1 të Ligji Nr. 16/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
III. Ndryshimi në Statut është:
Emrat e Bordit të Drejtorëve dhe përfaqësuesi i autorizuar (neni 14 paragrafi 2.1)
IV. Obligohet Sekretarja e Kompanisë të bëjë këtë ndryshim në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 09 Mars / 2023.

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Kryeshefit Ekzekutiv Z.Agron Tigani i shqiptohet masa disiplinore VËREJTJE ME SHKRIM.

2. Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për Janar-2023, me sugjerimet e dhëna.
3. Zyrtarit të Lartë Financiar Z.Rasim Maloku i shqiptohet masa disiplinore VËREJTJE ME SHKRIM.
4. Të gjitha automjetet zyrtare të Kompanisë me përjashtim të automjetit zyrtar të Kryeshefit Ekzekutiv dhe punëtorët (ekipet kujdestare) që ndihmojnë në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, pas përfundimit të orarit të punës, respektivisht përdorimit të automjetit duhet të parkohen dhe të qëndrojnë në parkingun e Kompanisë. Te gjitha automjetet zyrtare të KRU" Hidrodrini" Sh.A. Pejë duhet t'a kenë edhe logon e Kompanisë.
5. Aprovohet Organogrami i KRU "Hidrodrini" SH. A. Pejë, me sugjerimin për lektorim.
6. Aprovohet Raporti Vjetor i Performancës të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për vitin 2022, me sugjerimin për plotësim me të dhëna.
7. Aprovohet Raporti Vjetor - Hulumtimi i Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për furnizim me ujë dhe shërbime të kanalizimit të KRU"Hidrodrini" Sh. A. Pejë, për vitin 2022.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 24 Mars / 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për Shkurt -2023, me sugjerimet e dhëna.
2. Bordi i Drejtorëve emëron Z.Lulzim Pupovci ushtrues të detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në KRU'Hidrodrini" Sh. A. Pejë

I emëruari do ta ushtroj këtë pozitë me efekt nga dt.25.03.2023 me të gjitha kompetencat ligjore dhe statutare të Kryeshefit Ekzekutiv deri në përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv pas përfundimit të procedurave të konkursit publik.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve e datës 12 Prill 2023.

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Vazhdohet mandati i Zyrtarëve të Lartë të KRU "Hidrodrini" Sh. A.,Pejë deri në përzgjedhjen e kandidatit sipas procedurave të konkursit të shpallur publik si vijon:
 - 1.Z.Rasim Maloku - Zyrtar i Lartë Financiar
 - 2.Znj.Vjollca Imami - Sekretare e KompanisëTë emëruarit do të vazhdojnë ta kryejnë këtë detyrë me efekt nga dt.12/04/2023 me të gjitha kompetencat ligjore dhe statutare deri në përzgjedhjen e kandidatëve pas përfundimit të procedurave të konkursit publik.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 27 Prill 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

- 1.Aprovohet Raporti Operativ dhe Financiar i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë për Mars dhe TM1 - 2023, me sugjerimet e dhëna.

2. Aprovohet Raporti mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës i KRU "Hidrodrini" Sh. A. për TM1 - 2023.
3. I. Aprovohet Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. për TM1 – 2023.
4. Ish Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë Z.Agron Tigani, sistemohet në vendin tjetër të punës Inxhinier në Njësinë Operative të Deçanit.
6. I. Të Rishpallet konkursi publik për zyrtarin e lartë: Zyrtar Kryesor Financiar Konkursi publik të shpallet sipas Ligjit për Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike neni 21 paragrafi 21.4 dhe neni 17.1 që plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas neni 17.2 si dhe kriteret e përgjithshme.

Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve e datës 02 Maj 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Aprovohet Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 29 Maj 2023.

Mbledhja e jashtëzakonshme Bordit të Drejtorëve e datës 09 Qershor 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Aprovohet Statutit i K.R.U ' Hidrodrini 'Sh. A. Pejë

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 26 Qershor 2023

1. Vendimet e marra në këtë mbledhje:
2. Aprovohet procesverbali nga mbledhja e rregullt e Bordit të Drejtorëve datë:29.05.2023 dhe procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme datë: 09.06.2023
3. Shfuqizohet Vendimi Nr.2414/2023 datë: 27.04.2023
4. Shfuqizohet rregullorja mbi marrëdhënien e punës Nr. 559/2021 & rregullorja nr.76
5. e datës 28.10.2011, mbi kompensimin e benificioneve dhe të ardhurave tjera të punëtorëve.
6. Shujta e punëtorëve për ditë të punës të jetë në shumën prej 4 €.
7. Autorizohet z.Dri Cena, Kryeshef Ekzekutiv në KRU "Hidrodrini" SH.A., Pejë të ketë qasje në të gjitha llogaritë bankare që disponon KRU "Hidrodrini" SH.A.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 28 Korrik 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve Apropoj PV.e datës:26.06.2023
2. Aprovohet Rishikimi i PB/23.
3. Aprovohet rregullorja për matjen e konsumit të ujit dhe shtojca e kësaj rregulloreje
4. Aprovohet rregullorja për iniciimin e procedurës përmbartimore të organi përmbartues
5. Aprovohet kontrata e shërbimeve të ujit

6. Vula e financave të ndryshohet, të bëhet edhe unifikimi i vulave të rrumbullakëta dhe të protokollit në secilën NjO.

Mbledhja vjetore e Aksionarit dhe Bordit të Drejtorëve e datës 01 Gusht 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve Aprovoj Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të audituara për vitin/ 2022 dhe Letër Menaxhmentit dërguar nga Auditori i Jashtëm
2. Bordi i Drejtorëve Aprovoj, Raportin Vjetor/ 2022
3. Bordi i Drejtorëve Aprovoj, performancën e Menaxhmentit/2022 të KRU "HIDRODRINI"Sh.A.,Pejë

Mbledhja e jashtëzakonshme e dhe Bordit të Drejtorëve e datës 16 Gusht 2023

Rekomandimi i marrë në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve njëzëri mori rekomandim:
Rekomandohet KE të anulon procedurat përzgjedhjes së ish- zyrtareve të lartë, për shkak të jo kompetencës së prurjes së tyre.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 31 Gusht 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve Aprovoj PV: nga mbledhja e rregullt e Bordit të Drejtorëve 28.07.2023, mbledhja e Aksionarit dhe BD dt:01.08.2023 dhe mbledhja e jashtëzakonshme e BD dt:16.08.2023.
2. Aprovohet raporti operativ & financiar TM2/23
3. Të iniciohet rasti i hetimit me të gjitha pikat të cilat janë diskutuar si gjetje në Hidrodri dhe të bashkëngjiten edhe auditimet e bëra nga AB

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 28 Shtator 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve Aprovoj PV: nga mbledhja e rregullt e Bordit të Drejtorëve 31.08.2023
2. Të bëhet shuarja dhe inkorporimi i NjO të Pejës në kuadër të kompanisë dhe të gjitha detyrimet që i ka pasur NjO të barten tek shërbimet operative dhe të departamenti i zhvillimit.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 26 Tetor 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve Aprovoj PV: nga mbledhja e rregullt e Bordit të Drejtorëve 28.09.2023
2. Bordi i Drejtorëve Aprovoj TM3/2023, me plotësimet e kërkuara

3. Bordi i Drejtorëve aprovoj rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve dhe detyrave të punës
4. Bordi i Drejtorëve aprovoj rregulloren mbi pagat dhe kompensimet tjera

Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve e datës 30 Tetor 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve aprovoj PB/24/26, me plotësimet e kërkuara

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 30 Nëntor 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve aprovoj procesverbalet: nga mbledhja e rregullt e bordit të drejtorëve, datë:26.10.2023 dhe mbledhja e jashtëzakonshme, datë:30.10.2023
2. BD shfuqizoj vendimin nr.49-3 të datës: 28.07.2023 lidhur me rregulloren për matjen e konsumit të ujit.
3. BD aprovon rregulloren, për matjen e ujit, instalimin dhe leximin e pajisjeve matëse të ujit
4. BD me dy vota për dhe dy abstenime, vendosën që t'i vazhdohet kontrata për një mandat të plotë KE, Dri Cena.
5. BD njëzëri votuan që sekretares Kreshnike Dreshaj ti vazhdohet kontrata për një mandat të plotë.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve e datës 29 Dhjetor 2023

Vendimet e marra në këtë mbledhje:

1. Bordi i Drejtorëve aprovoj procesverbalet: nga mbledhja e rregullt e bordit të drejtorëve, datë: 30.11.2023
2. BD me dy vota për dhe dy abstenime, vendosën që t'i vazhdohet kontrata për një mandat të plotë ZKF, Besnik Zeqiraj

Informacione lidhur me kapitalin dhe dividnten.

Kredit e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë viti

Gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur e as nuk kemi iniciuar ndonjë marrëveshje me institucionet financiare për huazim apo tërheqje të kredisë.

2.7. Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv.

Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.11/108,të datës: 11.01.2023, Bordi i Drejtorëve, deri m datën 31.12.2023 ka mbetur ne përbërjen e njëjte si më poshtë;

1. z. Jusuf Nikçi- Kryetar i Bordit të Drejtorëve,
2. znj. Mevlyde Kelmendi-Begolli - Anëtare e Bordit të Drejtorëve,
3. z. Simon Balaj - Anëtar i Bordit të Drejtorëve,
4. z. Driton Sylqa - Anëtar i Bordit të Drejtorëve.

Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.1/327, të datës 26.01.2023 për emërimin e Komisionit të Auditimit në K.R.U "HIDRODRINI" SH.A-Pejë, të emëruar nga ministre znj.Rizvanolli KA mbetet në përbërjen e njëjte si më poshtë:

1. znj. Mevlyde Kelmendi-Begolli -Kryesuese e Komisionet të Auditimit,
2. z. Driton Sylqa - Anëtar i Komisionet të Auditimit,
3. z. Simon Balaj - Anëtar i Komisionet të Auditimit.

Tabela 1. Kompensimet e anëtareve të bordit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nga data 11.01.2023 deri me 31.12.2023

Emri Mbiemri	Pagat baze	Pagesa shtesë për mbledhjet e - KA (14mbledhje)	Kompensime për fund vit	Kompensime-ditët e ujit	Totali/€
1.Jusuf Nikçi	450.00	00.00	100.00	78.00	5,302.94
2.Mevlyde Kelmendi-Begolli	320.00	100.00	100.00	78.00	4,447.30
3. Simon Balaj	320.00	80.00	100.00	78.00	4,294.19
4. Driton Sylqa	320.00	80.00	100.00	78.00	4,317.07

Tabela 3. Numri i takimeve të bordit dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e BD.

Nr. Takimeve	Datat e takimeve	Pjesëmarrësit
1.	26.01.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli,Simon Balaj Driton Sylqa
2.	23.02.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
3.	19.03.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
4.	24.03.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli,Simon Balaj Driton Sylqa
5.	07.04.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
6.	27.04.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
7.	02.05.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
8.	29.05.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
9.	09.06.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
10.	26.06.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
11	28.07.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
12	01.08.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa

13.	16.08.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
14	31.08.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
15	28.09.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
16	26.10.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
17	30.10.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
18	31.11.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa
19	29.12.2023	Jusuf Nikçi, Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj Driton Sylqa

Pjesëmarrja në takimet e bordit nga data 16.01.2023 deri me 29.12.2023.

1. z.Jusuf Nikçi- Kryetar i Bordit të Drejtorëve
2. znj.Mevlyde Kelmendi -Begolli - Anëtare e Bordit të Drejtorëve
3. z. Simon Balaj - Anëtar i Bordit të Drejtorëve
4. z. Driton Sylqa - Anëtar i Bordit të Drejtorëve

Kryesuesi i BD dhe anëtarët tjerë nuk kanë munguar në asnjërin nga 19 takimet sa janë mbajturnë vitin 2023.

Komitetet e bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura.

Në kuadër të ndërmarrjes nuk kemi komisione tjera dhe për këtë arsye ekziston vetëm **Komisioni i Auditimit** i cili gjatë vitit 2023 ka realizuar këto takime si më poshtë.

Tabela 3. Numrin i takimeve të komisionit të auditimit dhe pjesëmarrja.

Nr. Takimeve	Datat e Takimeve	Pjesëmarrësit
1.	17.01.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
2.	22.02.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
3.	01.03.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
4.	20.03.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
5.	30.03.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
6.	24.04.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
7.	24.05.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
8.	22.06.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
9.	25.07.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
10.	28.08.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
11	25.09.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
12	24.10.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
13	24.11.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa
14	26.12.2023	Mevlyde Kelmendi-Begolli, Simon Balaj, Driton Sylqa

Pjesëmarrja në takimet e Komisionit të auditimit nga data 17.01.2023 deri me 26.12.2023.

1. Mevlyde Kelmendi-Begolli , Kryesuese e komisionit të Auditimit, ka marr pjesë në 14 takime,
2. Simon Balaj , anëtar i Komisionit të Auditimit, ka marr pjesë në 14 takime,
3. Driton Sylqa, anëtar i komisionit të Auditimit, ka marr pjesë në 14 takime.

Komisioni i Auditimit nga gjithsejte 14 takimet e mbajtur në vitin 2023 ka marr 135 rekomandime dhe mbi 50 sugjerim, gjithashtu ka identifikuar dhe hartuar listën për hartimin e 29 rregulloreve të brendshme që kompanisë i mungojnë.

Bordi i Drejtorëve, në mënyrë të rregullt ka vlerësuar parametrat e performancës së Kompanisë. Sa i përket Planit të Vitit 2023, Kompania ka arritur që ti realizoi pjesën më të madhe nga caqet e objektivave të Planit të Biznesit. Performanca Operative dhe Financiare e K.R.U."Hidrodrini" SH.A, gjatë vitit 2023 ka treguar përmirësime krahasuar me vitin 2022.

3.2 Burimet njerëzore

Zhvillimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore është në përputhje me objektivat, strategjinë dhe zbatimin e politikave përkatëse të kompanisë, kjo synon të krijojë një mjedis punë të përshtatshëm dhe motivues, i cili i shërben jo vetëm rritjes profesionale të punonjësve, por dhe përmirësimit të proceseve administrative të kompanisë.

Në vitin 2023 u realizuan disa ndryshime të strukturës organizative. Këto ndryshime synuan përmirësimin dhe forcimin e disa proceseve të rëndësishme, si dhe përshtatjen më të mirë të strukturave me detyrat specifike që burojnë nga objektivat dhe veprimtaria e Kompanisë.

Krahasuar me vitet e mëparshme, në vitin 2023, vihet re së kemi vijueshmëri të pjesëmarrjeve në aktivitete trajnuese, si pasojë e inkurajimit nga Menaxhmenti.

Pjesa tjetër e trajnimeve është zhvilluar në fusha të tilla si: auditimi i brendshëm, mbrojtje dhe siguri në punë, kontabilitet dhe financë, etj. Duhet theksuar së numri më i madh i trajnimeve profesionale është i fokusuar drejt ndërtimit të kapaciteteve të Kompanisë për përmbushjen e funksioneve të saj kryesore.

Një tjetër element i rëndësishëm i burimeve njerëzore është rekrutimi i stafit.


Gjatë Janarit të vitit 2023 numri total i punëtorëve ka qenë 244 , vlen të theksohet që gjatë këtij viti janë pensionuar 4 (katër) punëtorë, 1(një) ka vdekur ,4 (katër) kanë dhënë dorëheqje, ndërsa në muajin Dhjetor 2023 numri total i punëtorëve realizon të jetë 268.

Përfaqësimi gjinor i stafit, nuk është i ekuilibruar. Raporti i femrave është 12% ndërkohë që i meshkujve është 88%.

Tabelat e më poshtme paraqet numrin e punëtorëve dhe ndryshimet nga viti 2022-2023 dhe krahasimi sipas biznes planit.

Për Muajin	Dhjetor 2022 numri i përgjithshëm i punëtorëve	244
Për Muajin	Dhjetor 2023 numri i përgjithshëm i punëtorëve	268
Për Muajin	Dhjetor 2022 Numri i Punëtorëve sipas planit të Biznesit	245

Krahasimi i numrit të punëtoreve/sipas biznes planit 2022-2023 i paraqitur në diagram.



3.3 Mbrojtje dhe siguri në punë

Siguria dhe Shëndeti në Punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit të punëmarrësve përmes parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, si dhe trajnimin e punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës siguria dhe shëndeti në punë shqyrtohet prej shumë neneve, akteve normative të SSHP-së, rregulloreve e parimeve.

Aktet normative të SSHP-së. Kushtetuta e Republikës së Kosovës -neni 49, Ligji i Punës 03/L-212, Ligji për Inspektoratin e Punës. Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 04/L-161, Rregulloret e veçanta. Udhëzimet Administrative, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Ligji NR. 04/L-161 përmban parimet e përgjithshme si: Parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimin, konsultimin, trajnimin e të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre, udhëzime të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.

Bazuar në këto dokumente, parime, rregullore, akte normative dhe legjislacionin në fuqi, zyrtari/ja për SSHP-në ka të bëjë me informimin e të punësuarve lidhur me parandalimin e rreziqeve apo aksidenteve të mundshme në punë, bartjen e PPM dhe mirëmbajtjen e tyre, kujdesin për vete dhe për të tjerët, si dhe ambient të përshtatshëm për punë, për sigurinë dhe shëndetin e tyre.

Përmes këtij raporti vjetor po i përmbledh kërkesat e ndryshme, në situata të ndryshme:

Raportet nga Inspektimet, takimet rreth SSHP-së, trajnimet, ekzaminimet dhe kontrollet për të gjithë të punësuarit në KRU Hidrodriini, përfshirë edhe të gjitha njësitet si Deçan Junik, Klinë Istog, mungesën e PPM etj gjithnjë bazuar sipas ligjit.

Gjatë vitit 2023 sa i përket Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë janë bërë shumë kërkesa, inspektime tereni, rekomandime për të gjeturat dhe realizim edhe të disa kërkesave që ishin synimi ynë.

Synimi ynë për vitin 2023 ishte Trajnimi i të gjithë të punësuarve në KRU Hidrodrini, për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Dhënien e Ndhmës së Parë, për të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre, Kontrollet.

Ekzaminimet Mjekësore, Çertifikatat Shëndetësore, Respektimin e Ligjit kundër Duhanit si dhe Vlerësimin e Riskut në vendet e Punës, për të gjitha pozitat në Kompani.

Në të njëjtën kohë nga Zyrtarja për Mbrojtje dhe Siguri në Punë janë punuar dy punë, pra nga fillim viti deri kah mesi i vitit 2023, pozita nga Siguria dhe si Menaxhere e Kontratës për Sigurimet shëndetësore në mbarëvajtjen e rimbursimeve nga ana e Kompanisë së Sigurimeve ELSIG për punëtorët e KRU Hidrodrini.

Duke filluar që nga muaji Janar e deri në fund të muajit Dhjetor 2023 janë bërë shumë kërkesa të ndryshme bazuar në Ligjin Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë për ambient të mirë punë dhe shëndet e siguri të të gjithë, parandalimin e rreziqeve dhe aksidenteve, rekomandime e udhëzime nga të gjeturat prej inspektimeve të terrenit në vende të ndryshme si në ITUN, në të gjitha objekte e njësitet e KRU Hidrodrini, rrugë e lagje të ndryshme.

Janë bërë kërkesa për ekzaminimet dhe kontrollet mjekësore, për Çertifikatat shëndetësore si dhe për Vlerësimin e Riskut në vendin e punës, për të gjitha pozitat si dhe pjesëmarrja nëpër komisione nga ana e Zyrtares

Disa nga Kërkesat janë realizuar, ndërsa shumica kanë mbetur të porealizuara edhe pse janë përsëritur nga dy e tri herë.

Tetor- 4 Kërkesa nga Inspektimet, takim me NMA-Kompania për Vlerësimin e Riskut dhe trajnimin e punëtorëve dhe trajnime me punëtorët nga SSHP-ja

Nëntor-5 Kërkesa nga Inspektimet në ITUN, Istog, Çarshia e Gjatë, Uji i Zi, Objekti Administratës si dhe trajnime me punëtorë në administratë, lëndimi i punëtorit L.R-raport nga punëtori i lënduar, inspektim në vendin e ngjarjes ku ka ndodhë lëndimi matjet e pluhurit me NMA)

Dhjetor-3 Kërkesa nga Inspektimet (takim me NMA, Inspektim gjatë ndrrimit të Ujëmatëseve Zonal). Disa gjëra kanë filluar të përmirësohen dukshëm në procese e projekte të ndryshme.

Kemi mbajtë takime të përjavshme me Sekretaren e Kompanisë i gjithë Departamenti i Administratës, lidhur me çështjet e ndryshme, secili për punët dhe përgjegjësit e veta, për Raportet Mujore e Vjetore, për inspektimet në teren etj.

Këto janë disa nga kërkesat për vitin 2023, si dhe punë terreni pothuajse çdo ditë, përveç në mungesë të automjetit zyrtar e që e kemi problem kyç.

Të gjitha këto Kërkesa janë për ambient të mirë pune dhe për kushte më të mira për SSHP-në të të gjithë punëmarrësve dhe parandalimin e rreziqeve apo aksidenteve të mundshme gjatë punëve

Kërkesat e bëra ishin të problematikave të ndryshme si psh:

Kërkesa për Dalje Emergjente - shkallë, parrmaket përgjatë shkallëve, ambient të pastër, vende evakuimi nëpër objekte, për kutitë e ndihmës së parë, për furnizim me PPM dhe mirëmbajtjen e tyre, mbrojtëse adekuate për punët në thellësi e lartësi, shenjzime, sinjalizime, shkallë adekuate, rregullimi i Urës në Radavc, largimi i automjeteve apo gjëseneve me koroziion, largimi i gypave të azbestit sipas ligjit në vende adekuate, ndriçim nëpër stacione të klorimit, trajnime të

punëtorëve për SSHP-në, trajnime për Mbrojtjen kundër zjarrit, për rregullimin e dysHEMEVE tek zyra e Auditorës, në Objekt të Administratës për dritaret, hapjen e tyre, për qumësht për punëtorët klorues, për mirëmbajtjen e objekteve, oborreve, ambienteve të punës e rreth tyre.

Nga këto kërkesa të parashtruara. Është bërë rimbursimi i aparateve për fikjen e zjarrit.

Janë larguar disa gyp atë azbestit, janë mbështjellë me material adekuat dhe është rrethu vendi, ku janë në proces të largohen të gjitha dhe të groposen. Është rregulluar Ura në Radavc. Janë rregullu disa gjëra të vogla në Radavc, dryri etj, është pastru shtëpia e klorit tek Uji i Zi dhe oborri.

Është bërë Vlerësimi i Riskut në vendin e punës së bashku me trajnimin e punëtorëve për SSHP-në, projekti ka përfunduar në muajin Dhjetor, sipas kontratës në mes të KRU Hidrodrini dhe Kompanisë së licencuar NMA.

Punëmarrësit janë pajisur me Çertifikata trajnimi për SSHP dhe 25 nga punëtorët janë trajnuar për mbrojtjen kundër zjarrit.

Janë bërë ekzaminimet dhe kontrollet mjekësore për disa punëmarrës (shumicën) projekti është në proces e sipër drejtë përfundimit që të gjithë punëmarrësit të pajisen me Çertifikata Shëndetësore.

Në mungesë të planifikimit të buxhetit, si dhe mos përgjigjet nga ana e përgjegjëseve e shfave. Dritaret në Objekt Administratës nuk janë rregulluar. Të gjitha automjetet zyrtare pa aparate për fikjen e zjarrit dhe pa kuti të ndihmës së parë. Nuk janë rregulluar dritaret në Administratë. Nuk janë vendosur parmaket në një rën anë të shkallëve. Nuk ka kuti të ndihmës së parë në asnjë Objekt të të gjitha Njësive të KRU Hidrodrini.

Në Nj.O-Junik stafi kanë dalë në zyra të reja, zyrat kanë ambient të mirë, mungojnë kutitë për dhënie e ndihmës së parë. Është rregullu ambienti i kuzhinës për punëtorët e Nj.O-Deçan. Edhe në Nj.O në Deçan punëtorëve ju mungojnë PPM si në të gjitha Njësitet tjera, shenjzime, sinjalizime, mburoja, qizme, dorëza, uniforma e veshje adekuate kundër shiut

Mirëmbajtja në ambientet e Nj.O Deçan nuk është në nivelin e duhur, në oborr ka automjete përfshirë nga korrozioni. Në të gjitha njësitet e KRU Hidrodrini, kloruesve ju mungojnë veshjet adekuate në rast intervenimi si dhe maskat kimike, syzet adekuate, qizmet, uniformat kundër shiut, pra mungojnë shumica e PPM

Në të gjitha Njësitet e KRU Hidrodrini mungojnë shenjzimet, sinjalizimet, mburojat adekuate për thellësi në rast të shembjes së dheut, helmetat, dorëzat, qizmet, uniformat kundër shiut

Të gjitha automjetet zyrtare nuk kanë aparate për fikjen e zjarrit as kuti të ndihmës së parë. Zyrtarja për Mbrojtje dhe Siguri në Punë ka zhvilluar dy aktivitete në KRU Gjakova dhe KRU Mitrovica, në plan të vizitohen edhe KRU-të tjera me qëllim të bashkëbisedimit dhe inspektimit, rreth ideve e projekteve lidhur me Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Shpresojmë që këtë vit me rishikimin e buxhetit të analizojmë edhe rritjen e buxhetit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të hartojmë strategji e politika për integritetin e punëmarrësve, trajnime e udhëzime lidhur me SSHP, furnizimin me PPM, mbikëqyrje, efikasitet, siguri dhe shëndet në punë për të gjithë të punësuarit në KRU Hidrodrini në Pejë gjithnjë në përputhje me Legjislacionin.

Politikat dhe strategjitë e SSHP. Funkionimi i mirë i organeve kompetente

Grumbullimi i të dhënave nga tereni. Raportimi i aksidenteve, sëmundjeve e rreziqeve

Përcaktohen politikat për avancime Orientohet mbikëqyrja dhe rritet efikasiteti. Hartohen strategji zhvillimore.

3.4 Shërbimi juridik

Shërbimi juridik gjatë vitit 2023 ka kryer punë të ndryshme administrative dhe juridike

Kontratë	Aktvendim	Autorizim	Vërtetim	Konkurs	Shënim Zyrtar	Kërkesë	Kallëzim Penal	Njoftim	Aneksë
99	533	20	36	50	6	104	30	36	25

Nga data e autorizimit për 13.10.2023 përfaqësim të Kompanisë Rajonale KRU "Hidrodrini" Sh.A – Pejë deri në fund të vitit kalendarik janë punuar lëndët si në vijim:

Lënda me C.nr. 2012/23, me bazë juridike "Anulim Vendimi", ku Hidrodrini ka qenë e paditur, është dërguar përgjigje në padi, një seancë gjyqësore, AKTGJYKIMI ËSHTË MARR NË FAVOR TË HIDRODRINIT, është bërë ankesë nga pala paditëse, dhe është dërguar përgjigje në ankesë. Lënda momentalisht është në shqyrtim të ankesës nga Apeli.

Lënda me C.nr. 2691/21, me bazë juridike "Kompensim i pagës shtesë", ku Hidrodrini është e paditur, është dërguar përgjigje në padi.

Lënda me C.nr. 1993/23, me bazë juridike "Anulim Vendimi", është dërguar përgjigje në padi.

Lënda me C.nr.97/19, me bazë juridike "Kompensim dëmi", është mbajtur një seancë gjyqësore në terren, është caktuar ekspertiza gjyqësore.

Lënda me C.nr. 2835/23, me bazë juridike "Ndërprerja e kundërligjshme e marrëdhënies së punës", është mbajtur një seancë gjyqësore, është caktuar ekspertiza.

Lënda me C.nr. 2817/23, me bazë juridike "Kontest punë", është mbajtur një seancë gjyqësore, është caktuar ekspertiza.

Lënda me C.nr. 379/17, me bazë juridike "Vërtetim pronësie", janë mbajtur 2 seanca gjyqësore.

Nga gjithsejtë 34 lëndë sa janë dërguar në prokurori për kyçe ilegale në vitin/2023, vetëm për dy lëndë nuk është arrit marrëveshje përmes ndërmjetësimit.

Përveç punëve të larte cekuar shërbimi juridik ka hartuar këto rregullore:

- Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve dhe detyrave të punës
- Rregullores mbi pagat dhe kompensimet tjera

Ky shërbim ka kryer edhe punë tjera shtesë:

- Përpilimi i kontratave të ndryshme, sipas nevojave që ka Kompania ;
- Përpilimi i vendimeve sipas kërkesave të KE;
- Punimi dhe dorëzimi i vulave të unifikuara tek secila Nj.O dhe departament;
- Pjesëmarrja në komisione të ndryshme;

- Përfaqësimi i kompanisë në Pakurori dhe arritja e marrëveshjeve me ndërmjetësim etj;
- Janë shqyrtuar dhe zgjidhur, ankesat/kërkesat e konsumatorëve, gjithsejtë për vitin 2023 janë zgjidhur 24 ankesa/kërkesa të konsumatorëve.

Kontingjentet dhe detyrimet

Kompania ka obligime kontingjente të cilat gjenden ende në procedurë gjyqësore për të cilat nuk dihet sa do të jetë obligimi përfundimtar, me poshtë gjeni lëndët në mënyrë tabelare.

Data	Lënda	Paditësi	Të paditurit	Vlera (kontestit)	Statusi aktual
12.11.2021	C.nr.2691/21	H.P dhe S.Rr	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	12000 €	Në proces
18.05.2023	C.nr. 1993/23	A.T	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	E papërcaktuar	Në proces
27.09.2023	C.nr.2817/23	A T dhe R M	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	E papërcaktuar	Në proces
16.10.2017	C.nr. 379/17	N.P	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	Vërtetim pronësie	Në proces
16.03.2023	C.nr. 2012/23,	M. I	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	Shpenzimet procedural e	Në Apel
23.12.2022	C.nr. 594/22	B. A	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	E papërcaktuar	Në proces
29.09.2023	C.nr. 2835/23	V. I	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	8000 €	Në proces
31.01.2019	C.nr. 97/19	Q. B	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	E papërcaktuar	Në proces
23.06.2021	C.nr. 1813/21	R. B	Kru "Hidrodrini" SH.A - Peje	1500 €	Në proces

Vërejtje: në këtë tabelë janë lëndën që ende gjenden në procedurë gjyqësore për të cilat nuk dihet dhe as që mund të dihet shuma e sakte për pagës, pasi që për secilën lëndë veç e veç - Gjykata cakton ekspertin financiar për llogaritjen e shumës së parave për kompensim.

4. Departamenti teknik

Në kuadër të shërbimeve të departamentit teknik janë sektori për planifikim dhe zhvillim, ujësjellësit, kanalizimit, pompave dhe automjeteve, si dhe Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura.

Gjatë tërë vitit është raportuar në baza mujore mbi të gjitha aktivitetet e sektorit. Është arritur që të menaxhohet prodhimi i ujit, distribuimi si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përfshirë edhe Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura.

Departamenti teknik ka arritur të realizoj planin e prokurimit përkundër vështirësive që kemi hasur në interesim për të punuar nga operatorët ekonomik dhe si pasojë kemi pasur disa herë përsëritje të publikimit të tenderëve.

Kemi arritur të kryejmë një mbikëqyrje të rreptë mbi realizimin e projekteve në mënyrë kualitative dhe në kohë.

Një nga të arriturat e departamentit teknik është edhe krijimi i sektorit për reduktimin e humbjeve të ujit i cili është në pregaditje e sipër të një strategjie, duke mbledhur të dhënat e nevojshme për fillimin e punës.

4.1 Sektori për planifikim dhe zhvillim

Sektori për planifikim dhe zhvillim ka pregaditur me sukses të gjitha projektet që kanë qenë të parapara me plan të biznesit dhe ka realizuar mbikëqyrjen e të gjitha projekteve të cilat janë zbatuar dhe janë në realizim e sipër.

Nga projektet të cilat kanë pasur rëndësi të veçantë për KRUH janë:

- Kompletimi i të gjitha pikave të burimeve me ujëmatës, projekt ky që ka mundur të kemi një pasqyrë të saktë të prodhimit të ujit në baza mujore në të gjithë zonën e mbulueshmërisë së KRUH.
- Realizimi i projektit për zonat DMA në qytetin e Pejës, projekti përmes të cilit janë instaluar disa ujëmatës smart si dhe furnizimi me disa pajisje për detektimin e humbjeve të ujit.
- Ka filluar së implementuari projekti i ndërtimit të ujësjellësit në njësinë e Deçanit, projekt ky i cili do të mundësoj që banorët të cilët furnizohen me ujë nga sistemi i 10 fshatrave të marrin ujë më të sigurt dhe të kontrolluar në bazë të standarteve.

4.2 Sektori i ujësjellësit

Gjatë vitit të kaluar, përveç intervenimeve në baza ditore në të gjitha sektoret (tabela tek 2. Treguesit kryesorë të performancës) janë zhvilluar punët në shumë projekte kapitale me rëndësi për kompaninë.

Disa nga projektet kapitale të cilat janë realizuar ose janë në realizim e sipër janë:

- Rrjeti i ujësjellësit në Jarinë dhe bashkësinë territoriale Xhemail Kada, Pjesa veriore, Tabjet (faza e tretë)
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Pejës dhe në fshatrat e komunës së Pejës (dy LOT)
 - LOT 1: Qyteti
 - LOT 2: Fshatrat
- Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Njësitë Operacionale Istog, Klinë (dy LOT)
 - LOT 1: Nj. O. Istog
 - LOT 2: Nj. O. Klinë
- Funksionalizimi i DMA zonave në qytetin e Pejës
- Renovimi i Depos në Nj. O. Istog
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për Nj. O. Deçan, Gurrat e Hasan Agës
 - LOT 1: Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për burimin e gurrave të Hasan Agës.
 - LOT 2: Furnizimi dhe montimi i ujëmatësve dhe pusëve në fshatrat e njesise se Decanit
- Ndërtimi i trafos në Nj.O. Klinë
- Ndërtimi i rrethojave tek burimi i Ujit të zi
- Shtëpizë e parafabrikuar prej druri me montim në burimin Drini i Bardhë (për rojtar)
- Rehabilitimi i rrethojave të objektet e sistemeve të ujit, siç janë rezervuarët, burimet e ujit dhe të tjerë.
- Funksionalizimi i stacioneve të klorimit për ujin nga burimet Istog, Vrellë dhe të tjerë.
- Rehabilitimi i stacionit të klorimit në Pejë si dhe ndërrimi i pjesëve të vjetruara.

4.3 Sektori i kanalizimit

Sektori i kanalizimit ka vazhduar mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit rregullisht dhe me përgjegjësi ka mbajtur lartë nivelin e shërbimit, duke përfshirë deblokimin e pusëve dhe pastrimin e rrjetit.

Në pjesën e dytë të vitit 2023 është marrë nën menaxhim të tërë rrjeti i kanalizimit në njësinë e Deçanit, ku edhe pse kemi hasur në shumë probleme të natyrave të ndryshme si mungesa e stafit dhe makinerive është arritur të kryhet me sukses realizimi i mirëmbajtjes të gjithë këtij rrjeti.

Sektori i kanalizimit në bashkëpunim me sektorin e Planifikimit dhe zhvillimit gjegjësisht GIS-in ka kryer incizimin e rrjetit të kanalizimit dhe të gjitha pusëve në të dyja njësitë, atë të Deçanit dhe Junikut.



Rrjeti i kanalizimit dhe pusetat e regjistruara në GIS – Deçan



Rrjeti i kanalizimit dhe pusetat e regjistruara në GIS – Junik

4.4 Sektori i pompave

Sektori i pompave gjate vitit 2023 ka qenë një nga pjesët më problematike që ka sjellë probleme me thekstë veçantë në njësinë e Klinës dhe atë të Istogut, mirëpo me sukses kemi arritur që të gjitha problemet të evitohen në kohë rekord dhe t'i kthehemi realitetit, po ashtu në disa vende janë kryer intervenimet e duhura për renovim apo ndërrim komplet të stacionit të pompave duke filluar nga vetë pompa, elektromotorët dhe frekuentorët.

Gjatë vitit 2023 janë vendosur pompa të reja në disa lokacione:

- 1) Njësia Pejë
 - 2 x 5.5 kW – Novosellë, lagja Selimaj
 - 3 kW – Zatra, Ranch
 - 7.5 kW – Zahaq
 - 7.5 kW – Sigë
- 2) Njësia Istog
 - 2 x 5.5 kW – Kovragë
- 3) Njësia Klinë
 - 2 x 11 kW – Gjurgjevik
 - 3 x 5.5 kW – te pusët, Fabrika

Vendosja e frekuentorëve është realizuar në Istog 2 x 7.5 kW, në Gjurgjevik – Klinë 2 x 11 kW, në fabrikë - Klinë 22kW dhe 160kW.


4.5 Treguesit kryesorë të performancës

Më poshtë janë bashkëngjitur tabelarët vjetor të prodhimit të ujit si dhe intervenimeve të kryera në tëgjitha sektoret e departamentit teknik gjatë periudhës raportuese janar – dhjetor 2023

*Vërejtje: Prodhimi i ujit është nga muaji maj 2023.

Nr.to	Nr.nj	Njësia	Janar 2023	Shkurt 2023	Mars 2023	Prill 2023	Maj 2023	Qershor 2023	Korrik 2023	Gusht 2023	Shtator 2023	Tetor 2023	Netor 2023	Dhjetor 2023	Sasia vjetore m ³
Njësia Pejë															
1	1	Burimi i Radavcit					933,120.00	1,312,416.00	1,374,019.20	1,374,019.20	1,162,117.20	987,799.62	916,816.32	1,127,520.00	9,187,827.54
2	2	Burimi i Ujit të zi					829,440.00	1,103,500.00	1,098,144.00	876,096.00	943,949.00	1,175,893.00	1,064,920.00	1,198,155.00	8,290,097.00
3	3	Burimi i Ujit të bardhë					6,958.00	48,360.00	9,664.00	10,198.00	8,619.00	8,274.00	8,243.00	8,655.00	108,971.00
4	4	Burimi i Raushiqit						53,568.00	4,995.00	1,530.00	-	22,809.60	21,600.00	28,985.00	133,487.60
Sasia mujore (m³)			-	-	-	-	1,769,518.00	2,517,844.00	2,486,822.20	2,261,843.20	2,114,685.20	2,194,776.22	2,011,579.32	2,363,315.00	17,720,383.14
Njësia Istog															
5	1	Burimi i Istogut 1					239,690.00	152,020.00	222,570.00	268,160.00	222,140.00	219,100.00	205,900.00	182,760.00	1,712,340.00
6	2	Burimi i Istogut 2					505,900.00	385,200.00	444,700.00	522,000.00	445,700.00	465,700.00	502,300.00	442,000.00	3,693,500.00
7	3	Burimi i Istogut 3					347,600.00	231,900.00	348,300.00	415,300.00	336,000.00	271,100.00	171,200.00	56,300.00	2,177,700.00
